



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1113/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Milena Đerić dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.11.2021, mori këtë:

#### V E N D I M

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa Anr.1113/2021 e datës 13.11.2021 e paraqitur nga Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën ka kërkuar që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, t'i shqiptohet gjobë për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale 2021.

#### A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar ankesën Anr.1113/2021 të datës 13.11.2021 të parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, e cila pretendon se më datë 13.11.2021, rreth orës 16:30 në tubimin zgjedhor të LDK-së në Podujevë, janë parë fëmijë duke mbajtur materiale promovuse të fushatës, siç shihet dy fëmijë te mitur, duke mbajtur poster te subjektit politik LDK. Paraqitësi i ankesës pretendon se përdorimi i fëmijëve në fushatë është i ndaluar me rregulloren e re 20/2019, për fushatën e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet, përkatësisht nenin 5 paragrafi 3 pika d). Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi lidhur me rastin në fjalë, me propozim për panelin që të pranohet ankesa si e bazuar.

Në përgjigje në ankesë, subjekti politik LDK, thekson se ankesa e subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje, është e pa bazë, ngase një foto e tillë nuk provon diçka konkrete, sepse posteri që mbajnë fëmijët nuk provohet se ua ka dhënë ndonjë mbështetës apo aktivist i LDK-së,

është një foto që nuk është postuar në asnjë rrjet social dhe nuk e ka reprezentues asnjë mbështetës apo aktivist i LDK-se, posterin që mbajnë në duar personat në foto nuk i ka udhëzuar askush për veprime të tilla, pra pretendimi i ankuesit është supozim i rrezueshem, mbi ankuesin bje barra e provës i cili nuk ka paraqitur prova të besueshme. Andaj, subjekti politik LDK i propozon PZAP-së që ankesa e subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje të hudhet si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën dhe shkresat e lëndës vlerësoi se: Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, vendimet e tij i bazon në dëshmi qarta dhe bindëse siç është përcaktuar me nenin 117 paragrafi 3 i LZP-së, e që në rastin konkret fotografia e ofruar nga ankuesi se një fëmijë i mitur, është duke e mbajtur një flamur në dorë të subjektit politik LDK, për panelin është e paqartë dhe nuk është bindëse për të vendosur ndryshe në këtë rast, ngase prej fotografisë që gjendet në shkresat e lëndës nuk mund të provohet se fëmija është në fushatë zgjedhore apo në ndonjë tubim të fushatës zgjedhore apo është nxitur nga subjekti për veprime të tilla siç pretendohet nga ankuesi. Andaj, pretendimet ankimore të ankuesit së është bërë shkelja e Rregullës Zgjedhore 20/2019, për fushatën e zgjedhjeve, përkatësisht nenin 5 paragrafi 3 pika d), nga ana e subjektit politik LDK, janë të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore, për faktin siç i konstatua më lart nga provat shkresore nuk është vërtetuar në mënyrë të qartë se fëmijët e paraqitur në fotografi, a janë duke u përdorur nga subjekti politik LDK, për të bërë fushatë në emër të tyre, në ndonjë tubim elektoral, e që do të ndikonte për të marr një vendim ndryshe në këtë rast.

Nga arsyet e theksuar më lart e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, neni 117 paragrafi 3 neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me nenin 8 paragrafi 4 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.1113/2021 më datën 15.11.2021



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.